

PRANVERA E MADHE SHQIPTARE -40 VJET NGA DEMONSTRATAT E VITIT 1981 NË KOSOVË

(Pranvera e Madhe Shqiptare -40 vjet nga Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë), Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2023, 386 f.)

Ky libër përbëhet nga përmbledhja e kumtesave nga simpoziumi i mbajtur në shënim të 40-vjetorit të demonstratave, më 17-18 prill 2021 në Stuttgart të Gjermanisë. Përmbledhja është redaktuar nga Imer Xhemail Lladrovci, në cilësinë e konsullit të konsullatës së Republikës së Kosovës në Stuttgart, i cili ishte organizator i këtij simpoziumi. Përmbledhja në tërësi ka 380 faqe dhe është e faqosur sipas standardeve të zakonshme të botimeve.

Në veprën *“Pranvera e Madhe Shqiptare -40 vjet nga Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë”*, trajtohet një nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë bashkëkohore të Kosovës. Demonstratat e vitit 1981 përbëjnë një periudhë kthese ngase në mënyrë të hapur nëpër rrugët e qyteteve të Kosovës u kërkuar avancimi i të drejtave të shqiptarëve dhe në veçanti ndryshimi i statusit të Kosovës nga Krahinë Autonome në Republikë. Kjo kërkesë jo vetëm që nuk u mor parasysh nga Beogradi zyrtar, por për më tepër u ndërmor nga regjimi jugosllav një fushatë dhune dhe terrori ndaj organizatorëve të demonstratave dhe ndaj elitës politike e intelektuale shqiptare në Kosovë, fushatë që vazhdoi gjatë gjithë viteve ‘80-të dhe viteve ‘90-të, e që kulmoi në periudhën e luftës në Kosovë, 1998-1999, dhe mbaroi me çlirimin e saj më 12 qershor 1999.

Trajtimi i kësaj ngjarjeje nga autorë të ndryshëm ka shtuar vlerën e kësaj përmbledhjeje, ngase ka shumëllojshmëri pikëpamjesh, qasjesh e interpretimesh, që i ndriçojnë më tej faktet e panjohura për demonstratat e vitit 1981 në Kosovë. Kështu, përmbledhja me titull: *“Pranvera e Madhe Shqiptare -40 vjet nga Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë”*, fillon me një hyrje rreth rëndësisë së botimit të akteve të simpoziumit, dhe pastaj me fjalën hyrëse të simpoziumit, me autorësi të redaktorit, Imer Lladrovci, ku është pasqyruar rëndësia e Demonstratave të vitit 1981 në Kosovë dhe ndikimi i tyre në proceset e mëtejshme.

Kjo vepër përbëhet nga tridhjetekatër (34) punime, por është konceptuar të jetë e ndarë në dy pjesë: në pjesën e parë të titulluar trajtimet dhe vështrimet janë botuar shtatë (7) kumtesa, të cilat kanë vlerë të shtuar për Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë, ngase janë të mbështetura në burime

primare dhe ato bibliografike, ndërsa në pjesën e dytë të titulluar analiza dhe kujtime, janë botuar kumtesat e njëzeteshtatë (27) autorëve, të cilat më tepër janë shkruar në formë të vështrimeve dhe mbresave që këta autorë kanë për këtë ngjarje, shumica prej të cilëve ishin pjesë e saj.

Kështu, në pjesën e parë autorët në punimet e tyre kanë trajtuar disa nga çështjet më delikate që ndonëse i gjejmë të trajtuara edhe më parë në historiografinë shqiptare nga studiues të shumtë, megjithatë janë me vlerë për faktin se sjellin burime dhe interpretime të reja mbi ngjarjet e mars-prillit të vitit 1981 në Kosovë. Temat të tilla si Revolucioni i vitit 1981, kërkesat kryesore me në krye “Kosova Republikë”, trajtimi i personaliteteve kryesore si Jusuf e Bardhosh Gërvalla, Kadri Zeka etj., trajtimi i shtypit i Lëvizjes për Republikën e Kosovës, pasqyrimi i ngjarjeve të vitit 1981 në shtypin gjerman etj., janë trajtuar me mjaft profesionalizëm, ngase autorët në përpilimin e këtyre punimeve janë mbështetur në burime kryesisht të papublikuara më parë. Ky fakt, shton vlerën e tyre, ngase plotëson zbrazëtinë në historiografinë shqiptare në lidhje me Demonstratat e vitit 1981.

Jo më pak me rëndësi janë edhe punimet e pjesës së dytë, ku autorët kryesisht janë protagonistë të ngjarjeve dhe rezultatet e tyre i kanë mbështetur në kujtimet dhe mbresat që kanë për këtë periudhë delikate në historinë bashkëkohore shqiptare. Natyrisht, duke mos pasur referenca shkencore dhe meqë autorët shumica prej tyre nuk kanë tituj akademikë, nuk mund të vlerësohen punime shkencore, por, megjithatë plotësojnë nga një dimension tjetër pasqyrimin e Pranverës së Madhe Shqiptare. Nga sa më sipër, mund të konstatojmë që në mungesë të burimeve dhe të metodologjisë shkencore, punimet e pjesës së dytë kanë doza të subjektivitetit, megjithatë narracioni për ngjarjet e rrëfyera është autentik dhe korrekt. Andaj, publikimi i tyre gjithsesi që është vlerë e shtuar për shkencën shqiptare dhe kështu një mundësi më tepër për të njohur dinamikën e demonstratave të vitit 1981.

Si përfundim mund të themi se publikimi i veprave me përmbledhje të kumtesave ka rëndësi të jashtëzakonshme për së paku dy arsye thelbësore: *së pari*, se rritë cilësinë e simpoziumeve, konferencave dhe tryezave shkencore, ngase studiuesit marrin më me seriozitet punimet dhe kumtesat e tyre, si dhe shton vullnetin për pjesëmarrje në to; dhe *së dyti*, plotëson zbrazëtinë në historiografinë shqiptare në lidhje me çështje dhe nënçështje që nuk janë trajtuar ende sa dhe si duhet. Andaj, studiuesit e historisë dhe jo vetëm, mbi bazën e burimeve dhe interpretimeve të reja, si dhe me përdorimin e metodologjisë së fundit shkencore, bëjnë që në prezantimet e kumtesave të tyre të rrisin cilësinë e konferencave shkencore, ndërsa me publikimin e

këtyre kumtesave, të plotësojnë boshllëqet që janë evidente në historiografinë shqiptare.

Skender LUTFIU